

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal**, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyrtares ligjore Dafin Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit H.K.- U. nga P., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 109/18 të datës 01.02.2018, jashtë seancës, me datë 25.04.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 109/18 të datës 01.02.2018, për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

### URDHËR NDËSHKIMOR

**I akuzuari;**

**H.K.- O.**, i ati I., i lindur mëdt:..., me vendbanim në rr. "A.B.", nr. ...., Komuna P., me numër personal ..., shqiptar, - shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse,**

Me datë 29.12.2017, rreth orës 10:40, në rrugën "Sh." në P., e pandehura deri sa ishte duke drejtuar automjetin "A" të tipit "Ford Focus" me tafa ..., me të arritur përballë pompës së derivateve "I.P.", nga pakujdesia nuk e përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve në rrugë dhe dendësisë në trafik, në kundërshtim me nenin 53 të LRTR-së, ashtu që me anën e majtë të automjetit, saktësisht me pasqyrën e majtë e godet këmbësoren tani të dëmtuarën V.V., duke e përplasur në "parafango" të automjetit, me ç'rast shkakton aksidentin e trafikut, ku lëndime të lehta trupore pëson këmbësorja V.V..

**-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

### DËNIMIN ME GJOBË

Nëshumë prej **200(dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

**Obligohet:** i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia kompensoj shumën prej **40.88** euro për ekspertizën e komunikacionit, shumën prej **20** euro te ekspertizës mjeko-ligjore, si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

**Edëmtuara** – V.V., me vendbanim në rrugën "N.T.", Komuna Gj., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.109/18 të datës 01.02.2018, kundër H.K. nga P.,për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1të KPRK-së, iakuzuari sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhrin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Mendimi i ekspertit mjeko-ligjor e datës 24.01.2018, mendimi i ekspertit të komunikacionit edatës 21.01.2018, si dhe të shikohen skica dhefotografit e vendit të ngjarjes, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i përgjithshëm-Penal  
P.nr.869/18, të dt. 25.04.2018

**Zyrtare Ligjore**  
Dafian Ymeri

**Gjyqtari,**  
Kujtim Krasniqi

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.